**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**
**KËSHILLI I MINISTRAVE**
**KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT**

**V E N D I M**

Nr. 32, datë 24.12.2024

**PËR**
**MIRATIMIN E LEJES SË NDËRTIMIT PËR OBJEKTIN:**
**"GODINË BANIMI DHE SHËRBIMESH, ME 2 DHE 14 KATE MBI TOKË (12 KATE ME ATIK DUKPLEKS), ME 5 KATE NËNTOKË", ME VENDNDODHJE NË RRUGËN "VASO PASHA", BASHKIA TIRANË**

Në mbështetje të neneve 27 dhe 28, të Ligjit Nr. 107, datë 31.07.2014 "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit", i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 408, datë 13.05.2015 "Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit", i ndryshuar, si dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.519, datë 20.09.2017 "Për përcaktimin e përbërjes së Këshillit Kombëtar të Territorit", i ndryshuar, me propozim të subjektit zhvillues shoqërisë "Domus Group Al" sh.p.k, Këshilli Kombëtar i Territorit,

**VENDOSI:**

1. Miratimin me kusht të Lejes së Ndërtimit për objektin: "Godinë banimi dhe shërbimesh, me 2 dhe 14 kate mbi tokë (12 kate me atik dukpleks), me 5 kate nëntokë", me vendndodhje në Rrugën "Vaso Pasha", Bashkia Tiranë, me subjekt zhvillues shoqërinë "Domus Group Al" sh.p.k.

2. Harta e Planvendosjes se Strukturave dhe Dokumenti i Rregullores se Veçante bashkelidhen si pjesë përbërëse e këtij vendimi.

3. Dokumenti i Lejes së Ndërtimit i jepet subjektit kërkues vetëm pas:
   a) plotësimit të dokumentacionit tekniko-ligjor;
   b) pagesës së taksës së ndikimit në infrastrukturë për llogari të Bashkisë Tiranë.

4. Ngarkohet Agjencia e Zhvillimit të Territorit në bashkëpunim me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, për zbatimin e këtij vendimi.

5. Vendimi, pasi nënshkruhet nga Kryetari, Ministri i Linjës dhe Sekretari i Këshillit Kombëtar të Territorit dhe Ujit, hyn në fuqi menjëherë.

**K R Y E T A R I**

**E D I   R A M A**

MINISTËR I LINJËS

**MINISTËR I INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË**

**BELINDA BALLUKU**

ANËTAR/SEKRETAR I KKT

**DREJTOR I AGJENCISË SË ZHVILLIMIT TË TERRITORIT**

**ADELAJDA ROKA**

Nënshkruar më datë 06/10/ 2025